



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
KOMISIONI I PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK**

Tiranë, më ____/____/2025

**FLETËSHOQËRUESE
PËR DOSJEN E KANDIDATIT PËR MBROJTJEN E TITULLIT AKADEMIK
“PROFESOR I ASOCIUAR”/ “PROFESOR”**

Dosja që dorëzohet nga kandidati përmban dokumentet e mëposhtme:

- ☐ Kërkesën e kandidatit për mbrojtjen e titullit akademik “Profesor i Asociuar”/ “Profesor” ku të rezultojë dhe data e dorëzimit të dosjes.
- ☐ Shkresën e Rektorit të UT, për përcjelljen e dosjes së kandidatit për shqyrtim dhe vlerësim në KPPA.
- ☐ Shkresën e Dekanit të Fakultetit (Drejtuesit të Njesisë kryesore të IAL) drejtuar Rektorit të UT-së për përcjelljen e dosjes së kandidatit për tu shqyrtuar nga KPPA.
- ☐ Relacionet vlerësuese të relatorëve të njësisë bazë, ku do të përfshihet edhe argumentimi për ekuivalentimet përkatëse, sipas rastit, të monografisë, postdoktoraturës apo angazhimeve, në rast se këto kërkohen nga kandidati.
- ☐ Vendimin e njësisë bazë për vlerësimin e dosjes së kandidatit.
- ☐ Skedën e kandidatit për përmbushjen e kriterëve për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar”/ “Profesor” sipas formatit të miratuar.
- ☐ Fotokopjen e kartës së identitetit ose të pasaportës së kandidatit si dhe çertifikatë martesë nëse kandidati ka ndërruar mbiemër.
- ☐ Curriculum Vitae (Biografi profesionale) e kandidatit, të aktualizuar deri në momentin e aplikimit në formatin Europass.
- ☐ Kopjen e noterizuar të diplomës për gradën shkencore “Doktor”/ kur kandidati aplikon për titullin “Profesor i asociuar” ose të diplomës për gradën shkencore “Doktor” (si dhe njehsimi i saj nga MAS në rast studimesh doktorate jashtë vendit) dhe titullit “Profesor i Asociuar”, kur kandidati/ aplikon për titullin “Profesor”.
- ☐ Vërtetimin e punësimit aktual, lëshuar nga titullari i Institucionit.
- ☐ Vërtetimin për veprimtarinë e mësimdhënies (5 vite me kohë të plotë, ose 8 vite me kohë të pjesshme, apo një kombinim midis tyre), lëshuar nga Institucioni.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
KOMISIONI I PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK

- ☐ Vërtetimin për zhvillimin e një cikli leksionesh (prej te paktën 3 vite) kur kandidati aplikon për titullin “Profesor i Asociuar” ose vërtetimin që është titullar lënde, kur kandidati aplikon për titullin “Profesor”, të lëshuar nga Institucioni.
- ☐ Dëshminë e zotërimit të gjuhës së huaj.
- ☐ Listën e botimeve të artikujve shkencorë, e shoqëruar me kopje të botimeve si dhe të dhënat e revistave si dhe provë e indeksimit të revistave ndërkombëtare.
- ☐ Dokumentin e printuar që tregon se emri dhe punimi i kandidatit është i paraqitur në Scopus search author dhe/ose Web of science.
- ☐ Listën e referimeve në veprimtaritë shkencore, si: simpoziume, konferenca, kongrese ku përfshihen *programi, dëshmia e referimit (certifikata)* dhe *botimi në proceedings*, shoqëruar me dokumente origjinale.
- ☐ 2 CD/ Memory stick, me të gjitha materialet e skanuara të dosjes së aplikimit.
- ☐ Dokumenti që konfirmon pagesën e tarifës për aplikimin për titullin përkatës.

KOMENT PARAPRAK i sekretarisë së KPPA për dokumentacionin e paraqitur
(Vlerësimi sasior jo përmbajtësor)

- ☐ Dokumentacioni i paraqitur është i plotë
- ☐ Dokumentacioni i paraqitur ka mangësi

Komente për mangësitë:

Nënshkrimi i kandidatit

(Emër, Mbiemër, Firmë)

Sekretaria teknike e KPPA

(Emër, Mbiemër, Firmë)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
KOMISIONI I PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK**

**Vetëm në raste kur kërkohen ekuivalentime shtohet edhe kjo pjesë e fletës
shoqëruese**

- ☐ **Listë e monografive, e shoqëruar me kopje origjinale.**
- ☐ Dokumentin që vërteton se monografia përmbush kushtet e origjinalitetit;
 - ☐ Vlerësimet në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) Profesorë vlerësues të pavarur të fushës kërkimore shkencore nga të cilët, të paktën njëri prej tyre është nga vendet anëtare të BE-së, OECD-së ose G20-ës.
 - ☐ Vendim që Monografia është pranuar nga njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit.
 - ☐ Dokumentin që vërteton rankimin e shtëpisë botuese nga SENSE Ranking of Academic Publishers, në kategorinë A, B, C ose D në rastin e monografive të botuara jashtë vendit;.
- ☐ **Dëshmi për studime postdoktorate në një shtet tjetër (6 muaj).**
- ☐ Raport i detajuar për aktivitetin kërkimor-shkencor të zhvilluar gjatë studimeve postdoktorale, konfirmuar nga drejtuesi i studimeve doktorale si dhe Dokument që tregon për produktin dhe/ose rezultatin e studimeve postdoktorale të aplikantit.
- ☐ **Listë e pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme shoqëruar me dokumentat përkatës dhe vendimin e njësisë bazë ku aplikon kandidati që vlerëson aktivitetin e kryer nga kandidati.**
- ☐ **pjesëmarrja në komitete shkencore apo redaktuese duhet të dorëzohen:**
- ☐ Vërtetim i institucionit përgjegjës për organizimin e konferencës për pjesëmarrjen e kandidatit në komitete shkencore apo redaktuese të konferencave shkencore kombëtare/ndërkombëtare, të zhvilluara në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, ku specifikohet që kandidati ka vlerësuar, redaktuar apo kryer peer review për secilën konferencë.
 - ☐ Produktet e redaktimit apo peer review, që ka kryer kandidati.
- ☐ **veprimtari vlerësues si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të periodikëve ose jo periodikeve shkencorë kombëtarë/ndërkombëtare- duhet të dorëzohen:**
- ☐ Vërtetim i organit përgjegjës drejtues të periodikut apo jo periodikut që specifikon vlerësimet apo redaktimet që kandidati ka kryer si anëtar komiteti shkencor apo redaktues për llogari të periodikëve ose jo periodikeve shkencorë kombëtare.
 - ☐ Vlerësimet apo redaktimet që kandidati ka kryer.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
KOMISIONI I PROMOVIMIT TË PERSONELIT AKADEMIK

☐ **projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari**- duhet të dorëzohen:

☐ Vërtetim i njësisë apo njësive që kanë organizuar projektin për angazhimin dhe pjesëmarrjen në projekte kërkimore-shkencore, kombëtare/ndërkombëtare në nivel drejtuesi apo koordinatori si dhe anëtari;

☐ **përfitim të financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar** - duhet të dorëzohen:

☐ Dokument i lëshuar nga financuesi ose përfituesi i financimit, për rolin organizator dhe drejtues të kandidatit;

☐ **Projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin në rolin e koordinatorit të projektit** - duhet të dorëzohen:

- Dokumentin e lëshuar nga donatori i huaj ose përfituesi i financimit për rolin e kandidatit si koordinator **të projektit kombëtar ose ndërkombëtar**,
- Vlerësimin e njësisë bazë/kryesore ku aplikon kandidati, mbi përfitimin institucional nga ky projekt dhe rolin e kandidatit në të.

☐ **pjesëmarrja në vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtar ose ndërkombëtar** - duhet të dorëzohen:

- Vërtetimi përkatës i financuesit të projektit për këtë vlerësim,
- Vlerësimi që ka kryer kandidati;

☐ **pjesëmarrja dhe angazhimi si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare/ndërkombëtare** - duhet të dorëzohen:

- Vërtetimi i institucionit organizues ku të specifikohen dhe vlerësimet/peer review që ka kryer kandidati,
- Vlerësimi apo peer review që ka kryer kandidati.

☐ **pjesëmarrja në projektet e transferimit teknologjik të patentave** - duhet të dorëzohet:

- dokumentacioni përkatës lëshuar nga autoriteti përkatës ose vërtetimi që vërteton projektin e transferimit të teknologjisë.